

**AKT THEMELIMI**  
**Për krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar**  
**“3S” sh.p.k**

Sot, më datën 14.01.2025, **Z. Dorian Shehu** i lindur në Durres, Shqipëri më datë 30 prill 1982 mbajtës i leternjoftimit elektronik me numër personal I20430080V themeloi shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar “**3S” sh.p.k** si më poshtë vijon

**Neni 1**

Personat fizikë të sipërpërmendur, me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar, krijojnë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar (Sh.P.K.) me emërtimin “**3S” sh.p.k** Ortak i kësaj shoqërie është **Z. Dorian Shehu**.

Administrator i kësaj shoqërie caktohet **Z. Dorian Shehu**, shtetas shqiptar, lindur ne Durres me 30 Prill 1982, i pajisur me NID nr. I20430080V. Z. Shehu emerohet administrator i shoqerise per një periudhe 5 vjecare.

Shoqëria ka të drejtë të krijojë filiale të saja brenda dhe jashtë vendit në çdo kohë që do të vlerësohet e arsyeshme prej saj dhe me aprovimin e organeve kompetente.

**Neni 2**

Shoqëria “**3S” sh.p.k** gëzon statusin juridik të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “**Sh.P.K.**”. Veprimtaria e saj do të zhvillohet sipas dispozitave të kësaj kontrate, statutit të saj dhe legjislacionit në fuqi.

Selia e shoqërisë “**3S” sh.p.k** eshte: **Durrës, Lagjia Nr.1 Rruga “Taulantia” Tek Pista e Re.**

Statuti i shoqërisë i bashkangjitet këtij akti themelimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Shoqëria ka vulën e saj me logon dhe të dhënët të përcaktuara.

**Neni 3**

Veprimtaria e shoqërisë si person juridik fillon me aprovimin e krijimit të saj nga organet kompetente të shtetit dhe do të vazhdojë për një periudhë kohe pa afat të përcaktuar.

**Neni 4**

Shoqëria do të kryejë aktivitet me objekt:

- Tregimi me shumicë e pakicë i materiale të të gjitha kategorive dhe nënëndegëzime të tyre që përdoren në ndërtim, materiale elektrike, makineri pajisje të përdorshme në industrinë e ndërtimit, biznese profesionale mbështetëse, biznese shërbimi, bare-restorante hotele-shërbime, materiale elektroshtëpiake, mallrave dhe sendeve që kërkohen në treg dhe ku shoqëria parapëlqen të investojë dhe ushtrojë veprimtari tregtar, shitblerje, depozitim dhe marrje të përfaqësisë për materiale, makineri dhe prodhime të tjera në përgjithësi të lidhura me industrinë e ndërtimit, e pajisjeve industriale dhe të ngjashme me to;
- Import-eksport i materiale të ndërtimit, mjeteve motorike të rënda të përdorshme në ndërtim apo në industri të tjera të biznesit, pjesë këmbimi për to;
- Shit-blerje, marrje me qira dhe dhenie me qera dhe administrim për llogari personale ose të tretëve të veprave publike/private, civile/industriale, rurale/urbane, terrene, pasuri të paluajtshme, hapësira të ndryshme;
- Kryerjen e aktivitetit ne ndertimet civile, industriale, infrastrukturre, ushtarake etj., si per llogari te vet ashtu dhe per te tretet, ku perfshihen ndertime pallatesh banimi, godina social-kulturore, komplekse industriale, ndertimet rrugore,

hekurudha, porte, aeroporte, ura dhe vepra arti, centrale elektrike, linja te tensionit te larte dhe te mesem, ujesjellesa, kanalizime, impiante te pastrimit, sinjalistike rrugore, punime topo-gjeodezike etj;

- Sisteme kundra zhurmës për infrastrukturën e pajisjeve të lëvizshme, rikonstruktime, lotizime, prodhim materiale të ndërtimit dhe të gjitha nëndegëzimet dhe tregtimi i tyre, aktivitet imobiliar, marrja e licënsave të ndryshme në çdo aktivitet të ndërtimit apo lëndës së ndërtimit;
- Shfrytezim karrierash lumore dhe malore, prodhim inertesh, llaçi, betoni, parafabrikatesh, materialesh asfaltike, materialesh te tjera te nevojshme ne per gjithesi dhe per tregimin e tyre per kryerjen e punimeve te ndertimit ne per gjithesi si dhe tregimin e tyre;
- Punime inxhinierike projektimi, duke perfshire por pa u kufizuar ne vepra urbane, arkitekture, punime ndertimi, instalimi, pune hidraulike, punime rrugore dhe hekurudhere, ura dhe vepra arti, inxhinieri topografike dhe hidrologjike, inxhinieri, studime gjeologjike, pune inxhinierike te impianteve te prodhimit dhe transemimit te energjisë etj.
- Pjesemarrje ne tendera te te gjitha llojeve si dhe marrja persiper e projekteve te ndertimit vetem ose ne bashkepunim me çdo person fizik ose juridik nepermjet komisionit direkt per shtetin,
- Investimi ne instrumente financiare (te cilet perfshijne pa kufizime titujt e pjesemarrjes ne kapitalin e shoqerive tregtare, titujt e borxhit, aksionet ose kuotat ne fonde investimesh etj), investimi ne pasuri te paluajtshme dhe ne asete (te prekshme apo te paprekshme), si dhe
- Ofrimi i sherbimeve te konsulences per shoqerite e kontrolluara prej saj dhe/ose te trete (te cilet perfshijne pa kufizime konsulencen e teknike ne fushen e ndertimit, projektimit dhe manaxhimit te projekteve) ne perputhje me legjislacionin e zbatueshem ne territorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte saj,
- Të blejë e të shesë, marrë me qira ndërmarrje, degë ndërmarrjesh si dhe të ketë interesa ose pjesmarrje në shoqëri tregatre, ente, konsorciume, shoqëri të thjeshta, të themeluara apo në themelim e sipër, që kanë objekt të ngashëm me shoqërinë, të japë garanci, dorëzani, të marrë hua dhe ofrojë garanci pasurore në favor të të tretëve të jetë palë dhe të ofrojë shërbime, produkte, nëpërmjet të gjitha formave të kontraktimit apo prokurimit publik, marrëveshjeve apo trativave tregtare apo/dhe me karakter civil, etj;
- Gjithashtu, shoqeria mund te kryej cdo veprim, operacion apo transaksion tjeter komercial, industrial e finanziar, te dobishem apo plotesues ndaj perm bushjes se objektit te shoqerise, me kusht qe aktivitetet e mesiperme te mos jene ne kundershtim dhe mos alterojne objektin paresor te veprimitarise se shoqerise.

Kapitali i shoqerise eshte 100.000 Leke. Kapitali i shoqerise ndahet ne nje numer kuotash ne raport me kontributin e dhene nga cdo ortak ne shoqeri ku cdo ortak zoteron nje kuote te vetme ne shoqeri, kuota keto te shlyera si me poshte:

- **Z. Dorian Shehu** zotëruesh i një kuote me vlerë të përgjithshme 100.000 leke që përbën 100% të kapitalit të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve mund te jete ne para ose ne natyre (pasuri te luajtshme ose te paluajtshme apo te drejta). Ortaket per gjigjen per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

**Neni 6**

Fitimi neto nga aktiviteti i kësaj shoqërie i përket ortakëve të saj.

**Neni 7**

Për detyrimet që do të krijoen ndaj personave të tretë gjatë aktivitetit të kësaj shoqërie do të përgjigjet vetë shoqëria deri në kufirin maksimal të kapitalit të saj.

**Neni 8**

Marrëdhëni e punës në shoqëri dhe në filialet e saj rregullohen nëpërmjet kontratës së punës.

**Neni 9**

Dispozita të hollësishme mbi organinzipin e kësaj shoqërie përcaktohen në statutin e saj. Themeluesit e kësaj shoqërie, pasi e lexuan me vëmendje këtë akt themelimi dhe e gjetën në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me vullnetin e tyre, e firmosën pa vërejtje.

**ORTAKU I VETEM I SHOQERISE**



Dorian Shehu